

Sillabusi për lëndën ,Gramatikë historike e shqipes

Universiteti Hasan Prishtina

Fakulteti i Filologjisë

Dega e Gjuhës Shqipe

Titulli i kursit: **Gramatikë historike e shqipes**

Niveli dhe lloji i kursit: Lëndë obligative

Viti IV,sëmbestri VII

Vlera në kredi (ETC): 8

Numri i orëve 3+2

Mësimdhënëse:Prof.dr.ass.Hava Qyqalla tel.044 125886, imeli havaqyqalla@hotmail.com

Qëllimi i kursit:

-Thellimi i njohurive për strukturën e gjuhës në planin diakronik,sidomos të shumë çështjeve të strukturës aktuale të shqipes,të cilat do të ndriçohen, rindërtohen e aktualizohen përmes metodës historiko-krahasimtare të jashtme(krahasimit të shqipes me gjuhët e vjetra i.e.të cilat kanë një histori shkrimore mjaft të hershme) dhe asaj të brendshme (krahasimit të shqipes aktuale me fillimet e shkrimit të shqipes dmth me shqipen e shekujve 16 dhe me te folmen e arbëreshëve të Greqisë e të Italisë.

-Nxitja dhe motivimi për një interesim sa më të denjë për ngritjen në një vertikale të largët diakronike në një dimension sistemi të pashkëputur nga shqipja aktuale gjer në fazat më të largëta indoeuropiane.

-Aftësimi për mendime,gjykime ,teza e kundërteza rreth etimologjisë së pjesëve të ligjëratës dhe veçorive të tyre gramatikore.

Rezultatet e pritura të nxënies:

-Përvetësimi i njohurive dhe shkathësive bazë për zotërimin e gjendjes së strukturës së shqipes në një zhvillim sa më të largët historik,bazuar në rezultatet e arritura shkencore në këtë drejtim.

-Formimi i shprehive për punë të pavarur interpretuese, krijuese dhe shprehëse në thellimin e këtyre njohurive aq të errëta për strukturën e shqipes.

Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë ne gjendje:

-që bazuar në tezat e kundërtezat e e studiuësve të shumë të shqyrtojmë gjatë kursit,të aftësohet të gjykojë edhe vetë në argumentimin ose joargumentimin e këtyre tezave,

-të japë edhe vetë mendimet e veta për çështje diakronike ,tw cilat janë ende të diskutueshme.

-të formojë shprehi e shkathtësi për motivim të mëtejshëm në ndiçimin e [ështjeve diakronike për strukturën e shqipes etj.

Metodologjia e mësimdhënies: e kombinuar ,varësisht nga lloji i ligjëratës (shpjegim,sqarime udhëzime,diskutime debatuese ,demonstrim e interpretim,hulumtim i pavarur krijues etj.

Literatura bazë:

-Shaban Demiraj,Morfologjia historike e gjuhës shqipe,pjesa I dhe II,Prishtinë ,1980

-Shaban Demiraj,Gramatikë historike e gjuhës shqipe,Tiranë,2002

-Besim Bokshi,Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes ,
Prishtinë ,1980

-Idriz Ajeti,Morfologjia historike e shqipes,Prishtinë 1969

Plani detaj i mësimit, java ,temat dhe literatura:

Java I

Sistemi morfologjik indoeuropian ,karakteristikat tipologjike të shqipes së kohës i.e. dhe të shqipes së sotme

Literatura : Gramatikë historike e gjuhës shqipe,Tiranë,2002,fq.59-71

Java II

Dukuritë me karakter ballkanik të shqipes në fushën e morfologjisë(ballkanizmat në morfologji)

Literatura :Eqrem çabej,Studime Gjuhësore III,pjesa I (Hyrje në historinë e gjuhës me fonetikë historike) Prishtinë,1976,f.78-84

Java III

Fazat e zhvillimit të temave emërore të shqipes (sistemi A ,temat e shqipes (paraardhëses së shqipes) së periudhës indoeuropiane; sistemi B,temat e shqipes i.e të reduktuara ; sistemi C i temave që i krijoi theksi dinamik dhe sistemi D,temat e shqipe që njeh shqipja e dokumentuar) ecuria e zhvillimit të temave emërore të shqipes nga indoeuropianishtja gjer në shqipen e sotme ,transformimet që janë bërë gjatë kësaj periudhe të gjatë kohore.

Literatura:Besim Bokshi,Rruga e formimit të fleksionit të sotëm nominal të shqipes,Prishtinë,1980,f,147-183

Java IV

Tema emërore, Sufiksat e shqipes (sufiksat fjalëformues dhe trajtëformues) dhe Sufiksat modifikativë-feminativë; -ë, -e, -eshë, -ushë, -onjë, -icë, origjina e tyre.

Literatura: Besim Bokshi, vepra e cituar, f.64-70

Java V

Temat mbiemërore; temat e plota mbiemërore e temat jo të plota ose defektive mbiemërore dhe relacioni i tyre me mbaresën e gjinisë .

Literatura: Besim Bokshi, vepra e lartpërmendur, f.70-78

Java VI

Emri dhe kategoritë gramatikore të tij të vështruara në aspektin diakronik (sistemi trigjinish dhe proporcioni midis tyre në diakroni; shumësi i emrave, origjina e mbaresave të shumësit, shumësi i singularizuar; sistemi rasor i.e. origjina e mbaresave të shumësit.

Literatura:

Shaban Demiraj, Morfologjia historike e gjuhës shqipe I dhe II, f.46-74
Besim Bokshi, Rruga e formimit.....f.78-103

Vlerësim njohurish të lëndës së shtjelluar me test , Testi I

Java VII

Nyjat e shqipes, Nyja shquese, origjina dhe tezat për pozitën e saj burimore ndaj emrit dhe përfitimi i njëjës së përparme të emrave të farefisnisë, të ditëve të javës dhe mbiemrave të nyjshëm.

Literatura:

Shaban Demiraj, Gramatikë historike e gjuhës shqipe , 2002, f.151-180

Besim Bokshi, Prapavendosja e njëjës shquese në gjuhët ballkanike , Prishtinë, 1984,, sidomos pjesa e fundit, kreu III, f.177-198

Besim Bokshi, Rruga e formimitf.103-116 dhe 345-377

Java VIII

Tipat e përemrave dhe etimologjitë e tyre (përemrat vetorë unë ~ne, ti~ju);

Përemrat dëftorë ai/ajo, ata/ato, ky/kjo, këta/këto etj.) dhe përemrat pronorë; im/e, ynë, jonë tanë , e mi, e tu, yt, juaj, tuaj, i, e tij , i, e saj etj); përemrat pyetës e lidhorë dhe përemrat e pacaktuar në zhvillim historik.

Literatura: Shaban Demiraj, Gramatikë historike e gjuhës shqipe, Prishtinë, 2002, f.219-265

Besim Bokshi, Rruga e formimit.....f.117-132

Java IX

Sistemi foljor i shqipes në vertikalen diakronike,zgjedhimet e foljeve në periudhën i.e.të shqipes (Mi-koniugacioni ose zgjedhimi -mi, nga i cili në shqipen e sotme rezultojnë foljet; jam,kam dhe them/thom) dhe zgjedhimi –o/-io nga i cili rezultojnë të gjitha foljet e tjera të shqipes në rrjedhën e zhvillimit të tyre,të cilat klasifikohen në zgjedhimin I,II,III dhe IV.

Literatura :Shaban Demiraj,Morfologjia historike e gjuhës shqipe pjesa I dhe II,f.191-225

Shaban Demiraj,Gramatika historike e gjuhës shqipe, Tiranë,2002,f.295-323

Java X

Mënyrat e foljes në zhvillimet e tyre,mënyra dëftore,format sintetike të së tashmes,së pakryerës,dhe të së kryerës së thjeshtë në diakroni dhe transformimet e tyre gjatë kohës.

Literatura:Shaban Demiraj,Morfologjia historike e gj.shqipe,1976, f.225-273

Shaban Demiraj,Gramatika historike...,2002,f.323-346

Java XI

Format analitike të mënyrës dëftore ;e kryera,më se e kryera ,e kryera e tejkshuar dhe format analitike të së ardhmes, në zhvillimet e tyre brenda shqipes

Literatura Shaban Demiraj,Morfologjia historike e gj.shqipe,1976, f.274-293

Shaban Demiraj,Gramatika historike...,2002,f.347-363

Java XII

Mënyrat e tjera të foljes,(lidhorja,dëshirorja dhe urdhërorja) në diakroni,kohët e tyre dhe ndryshimet gjatë zhvillimit.

Literatura :Shaban Demiraj,Morfologjia historike..... f.294-323

Shaban Demiraj,Gramatika historike....., f.363-387

Vlerësim njohurish Testi II

Java XIII

Mënyra habitore, format kohore të saj dhe të lidhore-habitores gjatë zhvillimit historik,mendimet për formimin e koheve të saj,koha e formimit të tyre,haborja tek autorët e vjetër të shqipes,mungesa e saj tek të folmet e arbëresheve të Italisë dhe gjurmët e saj tek arbëreshët e Greqisë.Haborja e shqipes dhe mënyra e ritregimit ne bullgarishte, maqedonishte dhe turqishte.

Literatura: Shaban Demiraj,Morfologjia historike....f.324-339

Shaban Demiraj, Gramatika historike....., f.387-397

Besim Bokshi, Pjesorja e shqipes, vështrim diakronik, Prishtinë, 1998, f.98

Java XIV

Format e pashtjelluara të foljes

- Pjesorja në gjuhët i.e., pjesorja në shqipen e dokumentuar, tema e pjesores, prapashtesat e saj, funksionet dhe relacionet e saj homosintagmatike dhe heterosintagmatike.

Literatura: Shaban Demiraj, Gramatika historike....., f.397-408

Besim Bokshi, Pjesorja e shqipes, vështrim diakronik, Prishtinë, 1998, komplet monografia

Java XV

Format e pashtjelluara analitike

Tipat e paskajores dhe zhvillimi i tyre në shqipen. Paskajorja e tipit me ba dhe shtrirja e saj gjeografike, paskajorja e tipit për të bërë, etimologjia e saj forma mohore pa punuar, përcjellorja dhe format një të ardhur dhe me të ardhur dhe zhvilimet e tyre.

Literatura : Shaban Demiraj, Gramatika historike....., f.408-437

Besim Bokshi, Pjesorja e shqipes, vështrim diakronik, Prishtinë, 1998 sidomos pjesa II

Literatura plotësuese:

Shaban Demiraj, Gramatika historike e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1998

Idriz Ajeti, Historia e gjuhës shqipe, Morfologjia historike, Prishtinë 1969

Eqrem çabej, Studime gjuhësore III, pjesa I (hyrja në historinë e gjuhës me fonetikë historike, Prishtinë, 1969

Besim Bokshi, Prapavendosja e nyjës shqese në gjuhët ballkanike, Prishtinë, 1984

Besim Bokshi, Pjesorja e shqipes në vështrim historik, Prishtinë, 1998

Besim Bokshi, Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes, Prishtinë, 2011

Kolec Topalli, Gramatika historike e gjuhës shqipe, Prishtinë, 2012

Metodat e vlerësimit:

Vlerësimi I.....	20%
Vlerësimi II.....	25%
Angazhime të tjera në fakultet dhe në shtëpi.....	10%
Vijimi i rregullt.....	5%
Provimi	40%
Totali	100%